



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.226/2019

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Adnan Konushevcu dhe Zyhdi Haziri anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Lutfie M. Ajvazi, duke vendosur përkitazi me ankesën e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen me datë 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me 05.10.2019, mori këtë:

### V E N D I M

**Pranohet** e bazuar ankesa A.nr.226/2019 e datës 04.10.2019, e paraqitur nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, subjektit politik Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike - vendosja e posterëve të subjektit politik, për fushatën zgjedhore në “Shtëpinë e Kulturës”, “Luan rr. “Adem Jashari”, në Viti, i **SHQIPTOHET** gjobë në lartësi prej 3,500.00 (tre mijë e pesëqind) euro, të cilën gjobë detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë të këtij vendimi, nën kërcënim të përmbarimit.

### A r s y e t i m

Me datën 04.10.2019, PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, me të cilën pretendon se subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), ka vërejtur një Poster të kandidates për kryeministre nga radhët e LDK-së, Vjosa Osmani, e vendosur në “Shtëpinë e Kulturës”, në rr. “Adem Jashari”, në Viti.

Për këtë në kuptim të dispozitës në nenin 33 pika b), të LZP-së, lidhur me nenin 3 par. 3 pika 4 të Rregullores Zgjedhore 13/2013 të KQZ-së, e cila ndalon vendosjen e materialeve zgjedhore në vendet publike.

Parashtruesi i ankesës si provë materiale ka bashkangjitur fotografi.

Në përgjigjen në ankesë të datës 05.10.2019, subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), thekson se ankesa e subjektit të lartcekur është e pabazë, sepse postieri është vendosur në afërsi të “Shtëpisë së kulturës”, dhe se pavarësisht kësaj LDK, ka marrë masa duke e larguar nga vendi posterin në fjalë.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

## **Ankesa është e bazuar**

PZAP në bazë të dëshmvive të ofruara si provë materiale, disa fotografi, ka vlerësuar se subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), ka bërë shkelje të Kodit të Mirësjelljes për Subjekte Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, nga fakti se, ka vendosur një poster të kandidates për kryeministre nga subjekti politik LDK, në “Shtëpinë e Kulturës”, në rr. ”Adem Jashari”, në Viti, i cili paraqet veprime të sanksionuara me nenin 33 pika b), të LZP-së, lidhur me nenin 3 par. 3 pika 4 të Rregullores Zgjedhore 13/2013 të KQZ-së, e cila përcakton se ndalon vendosjen e materialeve zgjedhore në vende publike.

Paneli me rastin e shqiptimit të gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi mori parasysh shkeljet e lartpërmendura, dhe shqiptoj gjobën, duke u bazuar në nenin 120 par. 1 pika (c) LZP-së, nenin 3 pika 11 Rregullores për Nr.01/2012, për Kategorizimin e Sanksioneve dhe Gjjobave të PZAP-it, si dhe duke marr parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret ngase subjekti politik nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), ka marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara, që do të thotë se janë njoftuar me Rregullat zgjedhore. Po ashtu si rrethanë, lehtësuese PZAP-i e mori edhe faktin që subjekti politik në fjalë ia dha mundësin për t’u përgjigjur, ashtu që në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre shihet qartë se brenda afatit të caktuar kanë ndërmarrë veprime për të bërë përmirësimin e shkeljes, ashtu që e kanë tërhequr posterin, i cili veprim ka ndikuar në uljen e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Andaj bazuar ne te lartcekurat, PZAP-i, vlerëson se subjekti politik LDK, ka bërë shkelje të Kodit të Mirësjelljes, veprime këto që janë në kundërshtim me nenin nenit 35 të LZP-së, dhe neni 33 pika b), të LZP-së, lidhur me nenin 3 par. 3 pika 4 të Rregullores Zgjedhore 13/2013 të KQZ-së, e cila përcakton se ndalon vendosjen e materialeve zgjedhore në vende publike. Andaj, duke u nisur nga arsyet e theksuara me lart, e në kuptim të nenit 32 par.2, nenit 118 par.1 dhe nenit 120 par.1 pika (c) të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
A.nr. 226/2019 më datën 05.10.2019

**Kryesues i Panelit**  
Fejzullah Rexhepi



**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.